



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.51

3 maj

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 415 datë 7.4.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	2155
Ligj nr.10 417 datë 21.4.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së bashkëpunimit ushtarak financiar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”	2159
Ligj nr.10 418 datë 21.4.2011	Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor	2161
Dekret nr.6976 datë 19.4.2011	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare	2171
Dekret nr.6985 datë 20.4.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	2172
Vendim i KM nr.278, datë 6.4.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.1532, datë 19.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Korçë të qarkut të Korçës”	2173
Vendim i KM nr.310, datë 21.4.2011	Për përcaktimin e koston mesatare, lekë për metër katror, për objektet shtetërore të transformuara në fond banesash, kaluar në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi, për banorët posedues, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, të periudhës 2009-2011	2175

Udhëzim i MPPT nr.9, datë 2.5.2011	Për një ndryshim në udhëzimin nr.22, datë 12.10.2010 “Për procedurat e shitjes së objekteve të miratuara për privatizim sipas vendimit nr.676, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, të objekteve të ish-Qytetit të Nxënësve, pranë Shkollës së Mesme Teknologjike, Tiranë”, vendimit nr.678, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kthimin në fond banesash të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta, në Tiranë, të ndërmarrjes mekanike-tekstili, Tiranë, dhe të ish-Shkollës së Partisë, Tiranë”, vendimit nr.708, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për Entin Kombëtar të Banesave, të objekteve të Ish-Konviktit dhe të Shkollës Komunale, Tiranë, me qëllim privatizimi”, vendimit nr.1285, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e ish-objektit të kursit të ndërlidhjes së PTT-së, Tiranë, nga ish-Ministria e Ekonomisë dhe Privatizimit, sot Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi”, vendimit nr.601, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kalim objekteve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për Entin Kombëtar të Banesave, të objektit Ish-Kopshti nr.26, në Tiranë, me qëllim privatizimi”.....	2176
Urdhër i MD nr.3210, datë 25.4.2011	Për delegim kompetencash	2177
Vendim i ERE nr.30, datë 23.3.2011	Për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes nga KESH sh.a., së energjisë elektrike, nga tregtarët vendas dhe të huaj	2178
Vendim i ERE nr.32, datë 31.3.2011	Për mosfillimin e procedurave për rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	2185
Vendim i ERE nr.33, datë 6.4.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Idro Energjia Pulita” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	2186
Vendim i ERE nr.34, datë 6.4.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Bekim Energjetik” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	2187
Vendim i ERE nr.35, datë 6.4.2011	Për mosfillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Erald Energjitik” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	2188
Kërkesë e MPPT nr.1570/3, datë 30.3.2011	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan (loti I).....	2189

LIGJ
Nr.10 415, datë 7.4.2011

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008 “PËR
PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 41 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 41

**Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare
pa u regjistruar**

1. Kur administrata tatimore identifikon persona, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, atyre u mbyllet veprimtaria dhe u konfiskohen të gjitha materialet, sipas nenit 121 të këtij ligji.

2. Në rast se një person ushtron veprimtari në fushën e shërbimeve, i pajisur me leje/licencë/autorizim profesional, por nuk e ka regjistruar veprimtarinë në QKR, përveç konfiskimit të materialeve, administrata tatimore u propozon strukturave kompetente pezullimin e lejes/licencave/autorizimeve për ushtrim veprimtarie për një periudhë gjashtëmujore.”.

Neni 2

Në nenin 44, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Të gjithë tatimpaguesit, që rezultojnë mosdeklarues për më shumë se 5 vite kalendarike, duke filluar nga muaji janar i vitit pasardhës të vitit në të cilin tatimpaguesi është mosdeklarues, transferohen automatikisht nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv.”.

Neni 3

Në nenin 45, pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Subjektet e regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ose gjykatës çregjistrohen pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore të papaguara dhe pasi të kenë paraqitur bilancin e mbylljes, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Qendra Kombëtare e Regjistrimit ose gjykata njofton organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit apo për kërkesën për çregjistrim të personit fizik. Organi tatimor kompetent, brenda 30 ditëve nga data e këtij njoftimi, është i detyruar të verifikojë situatën tatimore të subjekteve deri në çastin e aplikimit për çregjistrim në QKR (në rastin e personave fizikë) ose deri në çastin e aplikimit për fillimin e procedurave të likuidimit në QKR ose në gjykatë (në rastin e personave juridikë) dhe, kur është e nevojshme, të ushtrojë kontroll në mjedisin ku ushtron veprimtarinë subjekti.”.

Neni 4

Në nenin 61, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Ministri i Financave cakton me udhëzim rastet kur palët e treta janë të detyruara të dërgojnë informacion për administratën tatimore, në mënyrë periodike, sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar.”.

Neni 5

Në nenin 65, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Detyrimi për të deklaruar ndërpritet në çastin e aplikimit në QKR për çregjistrim (në rastin e personave fizikë) ose deri në çastin e aplikimit për fillimin e procedurave të likuidimit në QKR ose në gjykatë (në rastin e personave juridikë).”.

Neni 6

Në nenin 93 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë”.

2. Në pikën 1 rreshti i parafundit, fjalët “nëpërmjet sekuestrimit të pasurisë së siguar” zëvendësohen me fjalët “nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguar”.

3. Në pikën 2 rreshti i parë, fjalët “nëpërmjet sekuestrimit dhe shitjes së pasurisë” zëvendësohen me fjalët “nëpërmjet sekuestrimit, konfiskimit dhe shitjes së pasurisë”.

Neni 7

Në nenin 96, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Nëse edhe me kalimin e 15 ditëve kalendarike nga sekuestrimi i pasurisë, bërë në përputhje me nenin 93 të këtij ligji, tatimpaguesi nuk shlyen të plotë detyrimin tatimor të prapambetur, pasuria e sekuestruar konfiskohet nga administrata tatimore dhe shitet në ankand publik, në përputhje me dispozitat procedurale të ligjit për ankandin publik.”.

Neni 8

Në nenin 105/1, në titull dhe kudo në përmbajtjen e këtij neni hiqen fjalët “të njërive të hetimit tatimor”.

Neni 9

Neni 119 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 119

Mosdeklarimi i punonjësve

1. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:

a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, gjobë prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh;

b) tatimpaguesit e tjerë, gjobë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh.

2. Për rastet e konstatuara nga zyra të shkeljes së afatit të deklarimit të punonjësve, sipas pikës 1 të këtij neni, tatimpaguesi dënohet me gjobë 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo deklaratë të padorëzuar apo të dorëzuar jashtë afatit.

3. Tatimpaguesi duhet të deklarojë në organin tatimor të larguarit nga puna brenda 10 ditëve nga data e largimit. Për shkeljen e këtij afati, detyrimet vlerësohen deri në datën e deklarimit të tyre në organet tatimore.”.

Neni 10

Në nenin 121, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Personi i identifikuar i paregjistruar, në kuptim të nenit 41 të këtij ligji, dënohet me konfiskim të të gjithë sasisë së mallit që mban në ruajtje, përdor apo transporton.”.

Neni 11

Në nenin 122 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 ndryshohen si më poshtë:

“b) nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, për çdo rast konstatimi:

i) për kontrollin e parë, me gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e tjerë;

ii) për kontrollin e dytë, me gjobë, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e tjerë;

iii) për kontrollin e tretë, me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë ose me mbyllje të veprimtarisë deri në 6 (gjashtë) muaj;

c) lëshon një kupon tatimor/dëftesë tatimore/biletë me vlerë të parashtypur, që nuk përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, për kuponin tatimor/dëftesën tatimore/biletën me vlerë të parashtypur, me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.”.

2. Shkronja “f” e pikës 1 shfuqizohet.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Moslëshimi i biletave të shërbimit me vlerë të parashtypur, të prodhuara nga institucionet e autorizuara, të përdorura në sektorë të ndryshëm, dënohet me gjobë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo biletë.”.

4. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në rast se një tatimpaguesi i është bllokuar veprimtaria nga administrata tatimore dhe ai prish shenjat dalluese të vendosura për bllokim të veprimtarisë, atij i konfiskohet e gjithë sasia e mallit.”.

Neni 12

Neni 123 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 123

Dënimet për shoqëritë e autorizuara dhe të paautorizuara

1. Shoqëritë e autorizuara, që tregtojnë dhe/ose mirëmbajnë pajisje fiskale, dënohen me gjobë, 50 000 (pesëdhjetë mijë) - 100 000 (njëqind mijë) lekë, nëse:

a) nuk sigurojnë miratimin e tipit në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, përpara hedhjes në treg të një tipi të caktuar të pajisjeve;

b) nuk sigurojnë mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, kur janë të autorizuara për një shërbim të tillë;

c) nuk kryejnë kontrollin periodik të pajisjeve fiskale, në mjediset e tatimpaguesit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji;

ç) nuk ndjekin procedurat dhe nuk respektojnë afatet e përcaktuara në aktet nënligjore, në lidhje me instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale;

d) nuk afishojnë në vend të dukshëm autorizimin e dhënë nga Ministri i Financave dhe autorizimet për tipat e pajisjeve, të cilat ato i tregtojnë në mjediset e shitjes.

2. Subjektet tatimpaguese, të cilat tregtojnë apo mirëmbajnë pajisje fiskale të subjekteve të tjera tatimpaguese, të paautorizuara nga Ministri i Financave, dënohen me gjobë, në masën 1 000 000 (një milion) lekë dhe sekuestrim të pajisjeve fiskale, ndërsa shoqëritë, që blejnë dhe përdorin pajisje të tilla fiskale, dënohen me gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe sekuestrim të pajisjes fiskale.

3. Shoqëritë e autorizuara nga Ministri i Financave dënohen me gjobë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) - 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për çdo rast, nëse:

a) nuk hapin skedarë dhe nuk mbajnë librin e mirëmbajtjes;

b) nuk shkruajnë të dhënat e nevojshme në librin e mirëmbajtjes;

c) nuk nënshkruajnë, si pjesë të kontratës, marrjen përsipër të mirëmbajtjes së pajisjes fiskale;

ç) nuk mirëmbajnë pajisjen fiskale dhe elementet e saj, brenda kushteve të përcaktuara;

d) nuk kryejnë vulosje të pajisjes fiskale;

dh) nuk vënë në dijeni administratën tatimore, në rastet kur tatimpaguesi ka ndërmarrë veprime për ndryshimin e të dhënave;

e) nuk vënë në dijeni tatimpaguesin, me të cilin kanë kontratë mirëmbajtjeje rreth heqjes apo pezullimit të autorizimit;

ë) nuk marrin në dorëzim të dhënat nga memoria fiskale, në prani të tatimpaguesit dhe të përfaqësuesve të administratës tatimore;

f) nuk ruajnë memorien fiskale në mënyrën e parashikuar nga dispozitat përkatëse.

4. Shoqëritë e autorizuara, që tregtojnë pajisje fiskale, dënohen me gjobë, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, kur konstatohet se tregtojnë pajisje fiskale me funksione të ndryshme nga ato të miratuara nga komisioni i ngritur për këtë qëllim në Ministrinë e Financave.”.

Neni 13

Në fund të nenit 133 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Tatimpaguesit, të cilët janë të çregjistruar në QKR, por që figurojnë të regjistruar në regjistrat përkatës të administratave tatimore, konsiderohen të çregjistruar nga këto administrata nga data e çregjistrimit të tyre në QKR. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, administratat tatimore marrin masat për pasqyrimin e këtij veprimi në regjistrat e tyre.

Tatimpaguesve, të cilët kanë bërë kërkesë për çregjistrim në QKR e më pas nuk kanë zhvilluar veprimtari ekonomike, por nuk kanë dorëzuar deklaratat tatimore me vlerë zero dhe, për këtë arsye, janë të evidentuar si debitorë pranë administratës tatimore, u falen gjobat dhe interesat për këtë mosdeklarim.”.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6981, datë 20.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 417, datë 21.4.2011

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT USHTARAK
FINANCIAR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e bashkëpunimit ushtarak financiar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6997, datë 29.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI USHTARAKE FINANCIARE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Qeveria e Republikës së Turqisë dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (tani e tutje në këtë dokument referuar si “palë” ose “palët”), duke marrë në konsideratë “Marrëveshjen mbi bashkëpunimin në industrinë e mbrojtjes”, të nënshkruar më 19 nëntor 1992 “Fushat ushtarake të trajnimit, teknikës dhe shkencës”, të nënshkruar më 29 korrik 1992 dhe “Marrëveshjen mbi fushat ushtarake të trajnimit dhe edukimit”, të nënshkruar më 19 nëntor 1992 në kuadër të marrëdhënieve të tyre miqësore afatgjata dhe me qëllim forcimin e bashkëpunimit të tyre ushtarak dhe për të dhënë një kontribut kundrejt forcimit të forcave ushtarake të Republikës së Shqipërisë, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qeveria e Republikës së Turqisë do të sigurojë një shumë të barasvlershme në dollarë amerikanë me 1 046 500 TL-lira turke (një milion e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind) në kuadër të bashkëpunimit ushtarak financiar dhe një shumë të barasvlershme në dollarë amerikanë me 128 800 TL-lira turke (njëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind) për Këshillin e Ministrave të Republikës së Turqisë. Burimet financiare të siguruar nga ana e Republikës së Turqisë do të përdoren duke filluar nga viti 2011 deri më 31 dhjetor 2015. Asistenca financiare do të përdoret pasi të ketë hyrë në fuqi protokollin i implementimit të asistencës financiare. Mbështetja logjistike në shumën e barasvlershme në dollarë amerikanë me 161 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë) TL-lira turke do të realizohet

në përputhje me parimet e protokollit të implementimit logjistik, i cili do të nënshkruhet më vete ndërmjet autoriteteve të të dyja palëve të referuara në këtë marrëveshje.

Neni 2

Fusha e veprimit

Shuma e barasvlershme në dollarë amerikanë me 1 046 500 TL-lira turke (një milion e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind) do të përdoret si ndihmë financiare për prodhimet e industrisë së mbrojtjes dhe prokurimin e shërbimeve të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të cilat do të realizohen nga institucionet apo kompanitë turke të industrisë së mbrojtjes sipas rregulloreve të Republikës së Turqisë.

Neni 3

Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit

Marrëveshja aktuale do të zbatohet nga Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Turqisë në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pikat e kontaktit për marrëveshjen aktuale janë zyra e atasheut ushtarak të Shqipërisë në Ankara dhe zyra e atasheut ushtarak të Republikës së Turqisë në Tiranë.

Neni 4

Parimet e implementimit

Shuma e barasvlershme në dollarë amerikanë me 1 046 500 TL-lira turke (një milion e dyzet e gjashtë mijë e pesëqind) do të vihet në dispozicion në rast se Këshilli i Ministrave i Republikës së Turqisë prokuron produktet e industrisë turke të mbrojtjes:

a) Nëse vlera e produkteve dhe shërbimeve të siguruara është më e madhe se shuma e barasvlershme në dollarë amerikanë me 1 162 777 TL-lira turke (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë), 90% e shumës së barasvlershme në dollarë amerikanë me 1 162 777 TL-lira turke (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) do të paguhet nga pala turke.

b) Nëse vlera e produkteve dhe e shërbimeve të siguruara është më e vogël se shuma e barasvlershme në dollarë amerikanë me 1 162 777 TL-lira turke (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë), 90% e shumës së vlerës së materialeve dhe shërbimeve të siguruara do të paguhet nga pala turke, si pagesë me para në dorë për institucionet dhe kompanitë e industrisë së mbrojtjes nga të cilat do të sigurohen produktet dhe shërbimet.

Pagesa do t'i realizohet kompanisë/institucionit përkatës nga ana e Ministrisë Turke të Mbrojtjes Kombëtare pas nënshkrimit të protokollit dhe deklaratës së Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë se dispozitat e protokollit janë përmbushur dhe që produktet/shërbimet janë dorëzuar. Prokurimi i produkteve dhe shërbimeve mbetet përgjegjësi e palës shqiptare.

Neni 5

E drejta e përdorimit të materialeve dhe shërbimeve

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bie dakord të mos ia transferojë të drejtën dhe të drejtën e përdorimit të materialeve dhe shërbimeve një vendi tjetër apo një palë të tretë pa pëlqimin paraprak të qeverisë së Republikës së Turqisë.

Neni 6

Çështje të tjera

Dispozitat e marrëveshjes, të referuara në paragrafin hyrës, do të mbizotërojnë për çështje që hasen/mund të hasen gjatë implementimit të marrëveshjes aktuale dhe për çështje që nuk parashikohen nga kjo marrëveshje.

Neni 7

Hyrja në fuqi, përfundimi, teksti dhe nënshkrimet

Marrëveshja aktuale hyn në fuqi në datën kur secila palë njoftohet përfundimisht nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi përfundimin e të gjithave procedurave ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë bie dakord t'i paguajë Qeverisë së Turqisë shumën neto të shitjes të marrë nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë nga shitja e çdo artikulli/prodakti mbrojtës të prokuruar nëpërmjet burimit nga Republika e Turqisë.

Marrëveshja aktuale mbetet në fuqi derisa materialet dhe shërbimet që do të përcaktohen në protokollet e implementimit të jenë hequr nga inventari i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe shuma neto e parashikuar t'i jetë paguar Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë.

Marrëveshja aktuale është hartuar në dy kopje origjinale, secila në turqisht, shqip dhe anglisht ku të gjitha tekstet janë njëloj të barasvlershme. Në rast mosmarrëveshesh lidhur me implementimin e marrëveshjes aktuale, mbizotëron versioni anglisht.

Palët i zgjidhin mosmarrëveshjet që dalin për shkak të implementimit të kësaj marrëveshjeje me anë të marrëdhënieve bilaterale pa e çuar çështjen për zgjidhje në një gjykatë ndërkombëtare, bord arbitrazhi apo pranë një pale të tretë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, përfaqësues të autorizuar sipas rregullave nga qeveritë/Këshilli i Ministrave të tyre përkatës, kanë nënshkruar marrëveshjen aktuale më 23 dhjetor 2010 në Ankara të Turqisë.

NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Altin Kodra
AMBASADOR I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË ANKARA, TURQI

NË EMËR TË QEVERISË
SË REPUBLIKËS TURKE

Fevzi Comert
GJENERAL BRIGADE
DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË
FINANCAVE NË MINISTRINË E
MBROJTJES TURKE

LIGJ

Nr.10 418, datë 21.4.2011

**PËR LEGALIZIMIN E KAPITALIT DHE FALJEN E NJË PJESE
TË BORXHIT TATIMOR DHE DOGANOR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj:

a) përcakton parimet dhe garancitë, veprimet e subjekteve që përfitojnë nga legalizimi i kapitalit, kompetencat e organeve të administratës publike e të bankave, që të marrin pjesë në procesin e legalizimit të kapitalit, si dhe veprimtaritë e lidhura me këtë proces;

b) parashikon faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor, kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe kompetencat e organeve të administratave tatimore e doganore, të cilat evidentojnë tatimpaguesit/debitorët që përfitojnë nga ky ligj.

Neni 2 Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është:

a) sigurimi i garancive ligjore të lidhura me procesin e legalizimit të kapitalit, ruajtjen e sekretit të subjekteve të përfshira në këtë proces dhe të informacioneve që ata i japin administratës apo subjekteve të tjera, të përfshira gjatë dhe pas legalizimit të kapitalit, si dhe mosfillimin apo ndërprerjen ndaj këtyre subjekteve, nga ana e institucioneve përkatëse të administratës tatimore e doganore, të procedurave administrative dhe të nxjerrjes së vendimeve të kundërvajtjeve administrative të lidhura me fshehjen e të ardhurave dhe/apo mospagimin e taksave dhe të tatimeve ndaj këtyre subjekteve;

b) sigurimi i garancive ligjore për pushimin e veprimeve procedurale të mbetura, të parashikuara në legjislacionin tatimor, doganor, si dhe atë të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore e që lidhen me mbledhjen me forcë të këtyre detyrimeve.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Legalizim i kapitalit” është:

a) deklarimi vullnetar i bërë nga individë, shtetas të Republikës së Shqipërisë, persona fizikë të regjistruar si të tillë në organet përkatëse, apo përfaqësues të këtyre dy kategorive të mësipërme, për zotërimin e shumave në të holla, brenda ose jashtë vendit, si dhe pagimi i tarifës së bërë në institucionet përkatëse për depozitimin e kësaj shume në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri;

b) deklarimi vullnetar i bërë nga persona juridikë, me seli në Republikën e Shqipërisë, të cilët janë të regjistruar në administratën tatimore të Republikës së Shqipërisë, i diferencës pozitive që rezulton nga rivlerësimi i pasurisë, i përcaktuar në këtë ligj, si dhe pagimi i tarifës së bërë në institucionet përkatëse për këtë rivlerësim.

2. “Shumë në të holla” është si kartëmonedha shqiptare me kurs ligjor, ashtu edhe monedha e huaj.

3. “Ruajtje e sekretit” është ruajtja e fshehtësisë për çdo veprim që mund të ketë pasur rezultat apo jo, për çdo fakt, për çdo informacion të ofruar nga subjekti i legalizimit apo përfaqësuesi i posaçëm i tij, për çdo të dhënë për kapitalin e legalizuar, me përjashtim të:

a) detyrimit për vënien në dispozicion të tyre nëpunësve shtetërorë të ngarkuar me detyra të lidhura me procesin e legalizimit të kapitalit;

b) detyrimit për vënien në dispozicion të tyre nëpunësve shtetërorë të punësuar në organet e administratës shtetërore dhe të autorizuar nga ky ligj për të ndjekur procesin e legalizimit të kapitalit;

c) rasteve të tjera të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 4 Zbatimi i ligjeve të tjera

1. Dispozitat e legjislacionit tatimor, doganor dhe të sigurimeve shoqërore, të cilat parashikojnë kompetencat e këtyre organeve të administratës publike, që janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij legjislacioni, duke përfshirë edhe përgjegjësinë për fillimin e procedurave administrative, gjatë kohës së zbatimit të këtij ligji, aplikohen në përputhje me këtë ligj.

2. Ndërprerja e procedurave administrative, e parashikuar në pikën 1 shkronja “a” të nenit 2 të këtij ligji, nuk zbatohet nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

3. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për kapitalin që përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

4. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për kapitalin e përfituar si rezultat i veprave penale të korrupsionit në sektorin publik ose privat, si dhe të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm.

KREU II LEGALIZIMI I KAPITALIT

SEKSIONI I RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR LEGALIZIMIN E KAPITALIT

Neni 5

Subjektet që përfitojnë nga procesi i legalizimit të kapitalit

Në rrethin e subjekteve, që përfitojnë nga procesi i legalizimit të kapitalit, përfshihen:

- a) personat fizikë apo juridikë, që deklarojnë, brenda kushteve të parashikuara nga ky ligj, shuma në të holla, dhe/apo diferencat pozitive që rezultojnë nga rivlerësimi i pasurive;
- b) individët, me shtetësi shqiptare, që deklarojnë, brenda kushteve të parashikuara nga ky ligj, shuma në të holla.

Neni 6

Subjektet e përjashtuara nga procesi i legalizimit të kapitalit

Nga të drejtat e parashikuara në këtë kre, nuk përfitojnë ata individë, të cilët, në përputhje me legjislacionin e fushës, i nënshtrohen detyrimit ligjor për deklarimin e pasurisë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

Neni 7

Organet shtetërore të përfshira në procesin e legalizimit të kapitalit

Në procesin e legalizimit të kapitalit marrin pjesë:

- a) autoritetet mbikëqyrëse të institucioneve financiare bankare, të organizuara dhe të rregulluara sipas ligjeve respektive;
- b) administrata doganore, administrata tatimore qendrore dhe lokale, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe institucione të tjera, veprimtaria e të cilave është e lidhur drejtpërdrejt me këtë proces.

SEKSIONI II PROCEDURAT E LEGALIZIMIT TË KAPITALIT

Neni 8

Kushti për deklarim vullnetar

1. Individët, personat fizikë, si edhe personat juridikë duhet të deklarojnë se duan të legalizojnë vullnetarisht kapitalin, të cilin nuk e kanë deklaruar më parë, ose për të cilin më parë kanë deklaruar një vlerë më të vogël se ajo çfarë duhet të deklarohet.

2. Deklarimi vullnetar është kusht për fillimin e procedurës së legalizimit të kapitalit.

Neni 9

Deklarimi i shumave në të holla nga individët

Deklarimi i shumave në të holla nga individët bëhet si më poshtë:

- a) individi ose përfaqësuesi i posaçëm duhet të plotësojë një formular aplikimi për depozitim të shumës në të holla në një numër llogarie bankare të hapur prej tyre për këtë qëllim. Aplikimi plotësohet në 2 kopje;
- b) formulari verifikohet nga banka, në prezencë të aplikuesit, për mënyrën e plotësimit të tij;
- c) banka, me marrjen e aplikimit, i jep individit ose përfaqësuesit të posaçëm kopjen e dytë të aplikimit, të verifikuar nga banka, me shënimin se është depozituar;
- ç) në rastet e deklarimit të shumave në të holla dhe të depozitimit të tyre në llogaritë bankare, banka mban, si tatim në burim, shumën prej 3 për qind të shumës totale të deklaruar;
- d) bankat transferojnë tatimet e mbledhura në llogaritë e thesarit të Ministrisë së Financave.

Neni 10

Deklarimi i shumave në të holla nga personat fizikë të regjistruar

1. Deklarimi i shumave në të holla nga individët e regjistruar si persona fizikë tregtarë bëhet sipas rregullave të nenit 9 të këtij ligji, duke përfshirë edhe pagimin e tatimit në burim. Personat fizikë tregtarë plotësojnë në formularin e deklarimit edhe numrin e identifikimit të personit tatimpagues, NIPT-it.
2. Detyrimet tatimore të këtij personi fizik, deri më 31 dhjetor 2010, konsiderohen të paguara rregullisht dhe administratat tatimore nuk mund t'i kërkojnë pagesën e detyrimeve të tjera shtesë ndaj atyre të paguara, për këtë periudhë.

Neni 11

Rivlerësimi i pasurive të personave juridikë

1. Personat juridikë, që kanë të regjistruar ne pasqyrat e tyre financiare pasuri të paluajtshme, makineri dhe pajisje me vlerë më të vogël se ajo e tregut, kanë të drejtë të bëjnë, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, rivlerësimin me vlerën e tregut të këtyre pasurive.
2. Rivlerësimi me vlerën e tregut bëhet nga ekspertë të pavarur të licencuar për vlerësimin e pasurisë, nga institucionet përkatëse.
3. Diferenca nga vlera kontabël e regjistruar në pasqyrat financiare me vlerën, që rezulton nga rivlerësimi, pasqyrohet në pasqyrat financiare të vitit 2011 dhe është e amortizueshme për efekte fiskale.
4. Personat juridikë paguajnë për këtë rivlerësim tarifat e mëposhtme:
 - a) 3 për qind të diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar, për pasuritë e paluajtshme;
 - b) 5 për qind të diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar, për makineri/pajisje.

Neni 12

Mbyllja e procedurave të legalizimit të kapitalit

Kapitali quhet i legalizuar sipas rastit:

- a) nga çasti kur shumat depozitohen në llogarinë përkatëse bankare, për individët dhe personat fizikë tregtarë, që deklarojnë shumat në të holla, dhe kur është paguar tatimi në burim, të parashikuar në nenet 9 e 10 të këtij ligji;
- b) nga çasti i aplikimit në administratën tatimore dhe i pagesës së detyrimeve, të parashikuara në pikën 4 të nenit 11 të këtij ligji, për personat juridikë, që rivlerësojnë pasuri të paluajtshme dhe makineri e pajisje.

Neni 13

Garancitë e subjekteve në procesin e legalizimit të kapitalit

1. Individët, personat fizikë tregtarë e juridikë, që marrin pjesë në procesin e legalizimit të kapitalit, gëzojnë këto garanci:

a) të ardhurat pas kryerjes së pagesës së detyrimeve, sipas parashikimeve në këtë ligj, konsiderohen si të ardhura, për të cilat detyrimet tatimore janë paguar në përputhje me legjislacionin shqiptar;

b) lejimin, në përputhje me ligjin, për mosdhënien e informacionit për sa i përket mënyrës së krijimit të këtyre të ardhurave;

c) të drejtën e ruajtjes së sekretit, sipas përkufizimit të këtij ligji, për sa i përket legalizimit të kapitalit;

ç) garanci për subjektet, që kanë legalizuar kapitalin, për mosdiskriminimin në të ardhmen, në procedurat e përllogaritjes së detyrimeve tatimore.

2. Çdo paqartësi në zbatimin e këtij ligji interpretohet në favor të subjekteve që legalizojnë kapitalin.

Neni 14

Kufizimet që pasojnë legalizimin e kapitalit

Bankat, në të cilat janë depozituar shuma në të holla, sipas këtij ligji, informojnë subjektet që deklarojnë për kushtet e parashikuara në këtë paragraf dhe në nenin 15 të këtij ligji, për rastet kur ata, pas legalizimit, mund të dëshirojnë të kryejnë transfera bankare për shumatat e deklaruara, sipas këtij ligji, ose ekuivalentin monetar të tyre në shuma më të vogla apo të barabarta me sasinë e legalizuar, jashtë shtetit, për tre vjet që nga data e legalizimit të tyre, si nga banka ku kanë legalizuar kapitalin, ashtu edhe nga banka të tjera, në të cilat kanë depozituar shuma në të holla.

Neni 15

Transferimi i shumave në të holla përpara afatit

1. Në rastet kur subjektet/individët, që kanë deklaruar shuma në të holla, dëshirojnë të transferojnë këto shuma ose ekuivalentin e tyre jashtë shtetit, përpara afatit 3-vjeçar nga data e legalizimit të tyre, u mbahet si penalitet:

a) 13 për qind e shumës së legalizuar, kur kjo bëhet brenda një viti nga data e legalizimit. Kur transferohen shuma më të mëdha ose më të vogla, shuma e penalitetit përllogaritet në raport me shumën e transferuar, por, në çdo rast, nuk mund të kalojë 13 për qind të shumës së legalizuar që transferohet jashtë shtetit;

b) 6 për qind e shumës së legalizuar, kur kjo bëhet pas një viti, por brenda dy vjetëve nga data e legalizimit. Kur transferohen shuma më të mëdha ose më të vogla, shuma e penalitetit përllogaritet në raport me shumën e transferuar, por, në çdo rast, nuk mund të kalojë 6 për qind të shumës së legalizuar, që transferohet jashtë shtetit;

c) 3 për qind e shumës së legalizuar, kur kjo bëhet pas dy vjetëve, por brenda tre vjetëve nga data e legalizimit. Kur transferohen shuma më të mëdha ose më të vogla, shuma e penalitetit përllogaritet në raport me shumën e transferuar, por, në çdo rast, nuk mund të kalojë 3 për qind të shumës së legalizuar që do të transferohet jashtë shtetit.

2. Penalitetet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni kalojnë në llogari të thesarit në Ministrinë e Financave, nga bankat, dhe janë në shtesë të shumës fillestare të paguar në çastin e legalizimit.

Neni 16

Përgjegjësia për zbatimin e kufizimeve për legalizimin e shumave në të holla

1. Përgjegjësia për zbatimin e kufizimeve në lidhje me transferimin e kapitalit jashtë shtetit i takon:

a) subjektit, që ka përfituar nga legalizimi i shumave në të holla, sipas këtij ligji, në rastet kur transferimi kërkohet të bëhet nga një bankë e ndryshme nga banka në të cilën është bërë legalizimi;

b) bankës, në rastet kur transferimi kërkohet të bëhet në bankën në të cilën është kryer legalizimi.

2. Banka qendrore, gjatë inspektimeve, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, deri në tre vjet pas përfundimit të kohës së zbatimit të tij, mban në konsideratë zbatimin e dispozitave të këtij ligji në lidhje me kufizimet e lëvizjeve të shumave në të holla jashtë shtetit.

Neni 17

Ndërprerja e procedurës me vullnetin e të interesuarit

Rastet e ndërprerjes së procedurave të legalizimit të kapitalit, nga vetë subjekti, për çdo shkak apo rrethanë, konsiderohen si raste, për të cilat procedura e legalizimit nuk ka filluar. Në këto raste subjekti i nënshtrohet detyrimeve të legjislacionit në fuqi.

KREU III

FALJA E DETYRIMEVE TATIMORE DHE DOGANORE

Neni 18

Subjektet që përfitojnë

1. Nga falja e parashikuar në këtë kre përfitojnë:

a) të gjithë tatimpaguesit, ndaj të cilëve administratat tatimore nuk kanë detyrime për rimbursim të shumave, pavarësisht nga shkakut i këtij rimbursimi, apo kreditim të tatimeve, si dhe kur nuk rezultojnë me tepriçë kreditore ndaj administratës tatimore;

b) të gjithë tatimpaguesit, ndaj të cilëve administratat tatimore kanë detyrime për rimbursim të shumave apo kreditim të tatimeve ose që rezultojnë me tepriçë kreditore, në rastet kur pranojnë, me shkrim, që shuma për t'u rimbursuar apo për t'u kredituar nga administrata tatimore të zvogëlohet në vlerë të barabartë me shumën e detyrimit tatimor të falur;

c) të gjithë debitorët ndaj administratës doganore, sipas përcaktimeve të nenit 26 të këtij ligji.

2. Procedura e aplikimit për falje të detyrimeve tatimore dhe doganore miratohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Nga falja e detyrimeve tatimore e doganore përjashtohen zyrtarët që kanë detyrimin për deklarim të pasurisë, si dhe personat juridikë, në të cilët këta zyrtarë kanë aksione apo kuota kapitali.

Neni 19

Detyrimet tatimore që falen pa pagesë

Falen pa pagesa në favor të Buxhetit të Shtetit:

a) të gjitha detyrimet tatimore të personave fizikë, të regjistruara si subjekt i taksës vendore të biznesit të vogël, të mbetura të papaguara e që i përkasin periudhës tatimore deri më 31 dhjetor 2010;

b) të gjitha detyrimet tatimore të papaguara të individëve për periudhën tatimore deri më 31 dhjetor 2010.

c) detyrimet tatimore të papaguara të tatimpaguesve, persona juridikë apo persona fizikë, të regjistruar si subjekt i TVSH-së, që janë të evidentuar në regjistrat e administratave tatimore deri në datën 31 dhjetor 2008.

ç) të gjitha detyrimet e prapambetura të pronarëve të mjeteve për taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe taksën vjetore të qarkullimit rrugor për periudhën deri më 31 dhjetor 2010. Gjithashtu, falen detyrimet për këto taksa, për të gjitha mjetet e dala jashtë qarkullimit, por të paçregjistruara deri në datën 31 dhjetor 2010.

Neni 20

Falja e detyrimit tatimor për tatimpaguesit, persona juridikë, apo tatimpaguesit e regjistruar si subjekt i TVSH-së

1. Detyrimet tatimore të papaguara të tatimpaguesve, persona juridikë, apo persona fizikë, të regjistruar si subjekt i TVSH-së, që janë të evidentuara në regjistrat e administratave tatimore në periudhën 1 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2009, falen nëse tatimpaguesi, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, paguan 30 për qind të principalit të tatimit.

2. Detyrimet tatimore të papaguara, të tatimpaguesve persona juridikë, apo persona fizikë, të regjistruar si subjekt i TVSH-së, që janë të evidentuara në regjistrat e administratave tatimore në periudhën 1 janar 2010 deri më 31 dhjetor 2010, falen nëse tatimpaguesi, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, paguan 50 për qind të principalit të tatimit.

Neni 21

Falja e gjobave të lidhura me detyrimin për t'u pajisur me pajisje fiskale

Të gjithë tatimpaguesve, subjekt i taksës vendore të biznesit të vogël, që janë dënuar me gjobë administrative për mosinstalim të pajisjeve fiskale dhe e kanë instaluar pajisjen fiskale brenda datës 28 shkurt 2011, u falen shumat e gjobave të papaguara për mosplotësimin në kohë të detyrimit për t'u pajisur me pajisje fiskale.

Neni 22

Deklarimi vullnetar i detyrimit tatimor

1. Tatimpaguesit, të cilët për periudhat tatimore deri më 31 dhjetor 2010, e kanë deklaruar shumën e detyrimit tatimor më të vogël se detyrimi real, kanë të drejtë që, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, të vetëdeklarojnë detyrimet reale tatimore përpara se ndaj tyre të ketë filluar një kontroll tatimor i administratës tatimore.

2. Tatimpaguesi, i cili deklaroi detyrimin real, në përputhje me pikën 1 të këtij neni dhe paguan 50 për qind të detyrimit tatimor të vetëdeklaruar, i falet pjesa tjetër e detyrimit, së bashku me kamatëvonesat dhe gjobat, që do të aplikoheshin në këto raste.

3. Dispozitat e nenit 18 të këtij ligji, lidhur me kompensimin e tepricave kreditore apo shumave për t'u rimbursuar, zbatohen edhe për këtë rast.

4. Tatimpaguesit nuk përfitojnë nga kjo dispozitë, nëse nga kontrolli tatimor rezulton se detyrimi tatimor është më i madh se ai i vetëdeklaruar, sipas këtij neni.

Neni 23

Falja e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të vetëpunësuarit

1. Tatimpaguesve, të regjistruar si të vetëpunësuar, duke përfshirë edhe të vetëpunësuarit në bujqësi, u falen:

a) të gjitha detyrimet e papaguara të lidhura me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për veten e tyre, për periudhën deri në fund të vitit 2008;

b) të gjitha detyrimet e papaguara të lidhura me derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për veten e tyre për periudhën nga 1 janari 2009 deri më 31 dhjetor 2010, me kusht që brenda datës 31 dhjetor 2011, të deklarojnë dhe të paguajnë të gjitha detyrimet që lindin gjatë vitit 2011.

2. Tatimpaguesit e përmendur në pikën 1 të këtij neni, që paguajnë të gjitha shumat e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, brenda afatit të zbatimit të këtij ligji, përfitojnë nga falja e të gjitha gjobave dhe kamatëvonesave të lidhura me detyrimet e pashlyera.

3. Periudha, për të cilën nuk janë paguar sigurimet shoqërore dhe për të cilën kontributi është falur, nuk do të konsiderohet për efekt të përfitimit të së drejtës për pension.

Neni 24

Falja e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për personat fizikë dhe juridikë

Të gjithë tatimpaguesve, persona fizikë dhe juridikë, të cilët nuk kanë derdhur të gjitha detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të lidhura me periudhën deri më 31 dhjetor 2010, u falen të gjitha shumat e gjobave dhe të kamatëvonesave.

Neni 25

Detyrimet e administratës tatimore

Administrata tatimore, brenda një afati, që përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave, evidenton kategoritë e tatimpaguesve, që përfitojnë nga falja e parashikuar në këtë ligj.

Neni 26

Falja e detyrimeve ndaj administratës doganore

1. Falen të gjitha detyrimet, gjobat dhe kamatëvonesat e debitorëve ndaj administratës doganore, të lindura deri më 31 dhjetor 2008 dhe të evidentuara nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate, të kontabilizuara deri më 31 dhjetor 2010 dhe të papaguara, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Të gjithë debitorëve ndaj administratës doganore që, brenda afatit të zbatimit të këtij ligji, paguajnë 50 për qind të shumës së principalit të detyrimit, të lindur gjatë vitit 2009 dhe të evidentuar nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate e të kontabilizuar dhe të papaguara deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, u falen gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me këto detyrime.

3. Të gjithë debitorëve ndaj administratës doganore që, brenda afatit të zbatimit të këtij ligji, paguajnë të gjithë shumën e principalit të detyrimit, të lindur gjatë vitit 2010 dhe të evidentuar nëpërmjet vendimeve të kësaj administrate dhe të kontabilizuar e të papaguar deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, u falen gjobat dhe kamatëvonesat e papaguara, të lidhura me këto detyrime.

4. Shtetasve, të cilët kanë futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë automjete deri në fund të vitit 2010 dhe që nuk i kanë paguar detyrimet ndaj administratës doganore, u falen pjesa tjetër e principalit së bashku me gjobat dhe kamatëvonesat, që do të paguanin, nëse paguajnë 50 për qind të principalit të detyrimit ndaj kësaj administrate.

Neni 27

Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme për individët

1. Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që, brenda kohës së zbatimit të këtij ligji, të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut.

2. Ky rivlerësim mund të bëhet nga një ekspert i licencuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme nga institucionet përkatëse ose nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

3. Në rast se individi zgjedh që të bëjë rivlerësimin me një ekspert të licencuar, atëherë aplikimit të tij për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme i bashkëlidh edhe aktin e vlerësimit të ekspertit.

4. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme llogarisin diferencën ndërmjet çmimit të kontratës së regjistruar në këtë zyrë dhe vlerës së pasqyruar në akt ekspertim, si dhe tarifën që duhet të paguajë individi për të regjistruar këtë rivlerësim.

5. Në rast se individi zgjedh që rivlerësimi të kryhet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme me çmimet minimale fiskale, atëherë ky fakt shprehet në aplikimin e tij për rivlerësim.

6. Në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme llogarisin diferencën ndërmjet çmimit të kontratës së regjistruar në këtë zyrë dhe vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale, si dhe tarifën që duhet të paguajë shtetasi për të regjistruar këtë rivlerësim.

7. Tarifa, që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi, është 1 për qind e diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit me vlerën e kontratës së regjistruar në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

8. Në rastet kur pasuria e paluajtshme rezulton e regjistruar pa një kontratë shitjeje, atëherë, si vlerë regjistrimi, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, konsiderohet vlera e çmimeve minimale fiskale në çastin e regjistrimit.

9. Aplikimi bëhet sipas formularëve standardë, të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave.

10. Për shitjen e pasurisë, të bërë pas rivlerësimit, tatimi llogaritet si diferencë e çmimit të shitjes dhe çmimit të dalë nga rivlerësimi.

Neni 28

Procedura e shuarjes së borxhit fiskal

1. Brenda 2 muajve pas përfundimit të periudhës së zbatimit të këtij ligji, administratat fiskale përgjegjëse shuajnë detyrimet fiskale të falura, sipas këtij ligji, dhe bëjnë pasqyrimet e këtij fakti në regjistrat e tyre kontabël.

2. Procedura e shuarjes së detyrimeve fiskale të falura dhe të detyrimeve fiskale, të cilave u ka kaluar afati i parashkrimit, përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

KREU IV

FALJA E DETYRIMEVE TË TJERA

Neni 29

Falja e detyrimeve të papaguara të energjisë elektrike

1. Falen detyrimet e prapambetura për energjinë elektrike, të faturuar dhe të papaguar deri më 31 dhjetor 2006, ndaj shoqërisë KESH, sh. a. nga debitorët familjarë të përcaktuar në këtë nen.

2. Falen kamatëvonesat e përlllogaritura nga mospagesa e faturave të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Përfitojnë nga falja e parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni debitorët, sipas kategorive të mëposhtme:

a) kryefamiljarët e familjeve që përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike;

b) familjet që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuara, të verbër, paraplegjikë ose tetraplegjikë, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të komisioneve mjekësore të posaçme dhe që përfitojnë pagesë aftësie të kufizuar, kur personi është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik a privat ose të vetëpunësuar në sektorin privat;

c) kryefamiljarët që përfitojnë pagesë papunësie dhe që nuk kanë të ardhura të tjera;

ç) kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie dhe jetojnë të vetëm ose kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura dhe janë të papunë;

d) kryefamiljarët që përfitojnë pension, për të gjitha kategoritë, si dhe përfituesit me trajtim të veçantë, që kanë masë përfitimi më të vogël se të ardhurat minimale që përfitojnë pensionistët, të cilët janë pa të ardhura të tjera;

dh) kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik a privat ose nuk janë të vetëpunësuar;

e) gratë kryefamiljare;

ë) të gjithë personat kryefamiljarë që gëzojnë statusin e jetimit.

4. Përfitojnë nga ky ligj të gjitha kategoritë e parashikuara më sipër dhe që e përfitojnë këtë status në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. Shoqëria KESH sh. a. bën zbritjen e këtyre detyrimeve nga bilancet financiare të saj. Për efekte fiskale, këto detyrime nuk njihen as si borxh i keq dhe as si shpenzim i njohur.

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Brendshme që, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe rregullave për mënyrën e evidentimit të debitorëve që përfitojnë nga kjo falje.

Neni 30

Falja e detyrimeve të faturave të papaguara të konsumit të ujit për konsumatorët familjarë

1. Konsumatorëve familjarë dhe jofamiljarë u falet detyrimi, së bashku me komponentët e tij, si gjobat dhe kamatëvonesat e konsumit të ujit, që kanë ndaj ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital tërësisht shtetëror të ujësjellës-kanalizimeve, deri në datën e bërjes efektive të transferimit të shoqërive pranë njësive të qeverisjes vendore, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2010.

2. Ndërmarrjet dhe shoqëritë me kapital tërësisht shtetëror të ujësjellës-kanalizimeve bëjnë zbritjen e këtyre detyrimeve nga bilancet financiare të tyre. Për efekte fiskale, këto detyrime nuk njihen as si borxh i keq dhe as si shpenzim i njohur.

3. Ngarkohen drejtoritë e ujësjellës-kanalizimeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij neni.

Neni 31

Falja e gjobave të vendosura nga inspektorët e kontrollit rrugor të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

Të gjithë drejtuesve të mjeteve apo pronarëve të tyre, të cilëve u është vendosur gjobë nga inspektorët e kontrollit rrugor deri në datën 31 dhjetor 2010, u falen shumat e gjobave të papaguara dhe kamatëvonesat e tyre.

Neni 32

Falja e detyrimeve të papaguara të tatimpaguesve ndaj administratës tatimore e veprimet me të ardhurat jotatimore

Falen të gjitha detyrimet e papaguara të tatimpaguesve nga veprimet me të ardhurat jotatimore, të tilla si mospagesat për arka regjistruese, certifikata tatimore, shtypshkrime, fatura tatimore, pullë akcize apo bileta transporti.

KREU V

ANKIMI DHE SANKSIONET

Neni 33

E drejta për ankim

Ndaj vendimeve të organeve të administratës publike, të parashikuara në këtë ligj, subjektet kanë të drejtën e ankimit në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 34

Sanksione

1. Shkelja e procedurave të parashikuara në këtë ligj përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas rregullave të mëposhtme:

a) shkelja e procedurave të legalizimit të kapitalit nga banka dënohet, me urdhër të Ministrit të Financave, me gjobë administrative nga 100 000 deri në 200 000 lekë, për çdo rast;

b) mosushtrimi në kohë i procedurave të parashikuara nga ky ligj, për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme nga nëpunësi i zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme dënohet, me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, me gjobë nga 5 000 deri në 10 000 lekë, për çdo rast.

2. Vendosja e sanksioneve sipas këtij neni nuk përbën shkak për ndërprerjen e procedurës së legalizimit të kapitalit, nëse ajo është në përputhje me këtë ligj.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 35

Koha e zbatimit

E drejta e subjekteve që të përfitojnë nga legalizimi dhe falja, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, mund të ushtrohet deri në datën 31 dhjetor 2011.

Neni 36

Aktet nënligjore

1. Ministri i Financave, me urdhër, miraton formularët e aplikimit për përfitim nga procesi i legalizimit të kapitalit.

2. Ministri i Financave nxjerr udhëzim për zbatimin e neneve 11, 12, 15, 19, 20, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28 të këtij ligji.

3. Aktet nënligjore, të parashikuara nga ky ligj, miratohen brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 37

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6998, datë 29.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

DEKRET

Nr.6976, datë 19.4.2011

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Agim Asllan Koni
2. Alketa Servet Tërpollari
3. Altin Hysni Dervishi
4. Anila Çuman Beqiraj
5. Anjeza Sadush Duske (Hyseni)

6. Arben Feta Nuhaj
7. Behar Mejtım Wiedon (Kojku)
8. Blerina Myrteza Hida (Hasalla)
9. Daniel Romeo Saraçi
10. Denise Zef Steinbach (Fistani)
11. Dritan Osmen Osmani
12. Dritan Thoma Cero
13. Elda Ymer Poser (Muça)
14. Eleni Dhimitër Leni
15. Eleonora Taqi Friese (Dhamo)
16. Elvis Bajram Muça
17. Erka Enver Muçaj
18. Fatjona Gjon Dedaj
19. Fatmira Ismail Feka (Hilaj)
20. Gentian Kamber Kamberaj
21. Jeta Kristaq Dhami
22. Klelia Xhemal Kondi
23. Klodian Ilia Vasho
24. Krenar Hamdi Rustemaj
25. Leonard Dedë Biel (Pllumbaj)
26. Liljana Kadri Ademi (Kusi)
27. Manuela Kol Fiedler (Panda)
28. Marjana Xhelo Tanuzi (Myslymi)
29. Markeliana Maksim Shehu (Gjini)
30. Mentor Avdi Sheta
31. Rudina Vehbi Balliu (Fortuzi)
32. Serina Dashamir Baruti
33. Thoma Dhimitër Leni
34. Yvonne Klemend Bregu
35. Zyhdi Mehmet Zhegu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.6985, datë 20.4.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të nenit 9 pika 7, nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", i ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:

Flaka Ismet Hamiti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.278, datë 6.4.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1532, DATË 19.11.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM TË BASHKISË KORÇË TË QARKUT TË KORÇËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të nenit 8/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike, të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit që i bashkëlidhet vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.1532, datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Korçës të qarkut të Korçës” hiqen pronat me nr.956, 861, 864, sipas formularëve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Bashkisë Korçë i revokohet e drejta e pronësisë për pronat me nr.956, 861, 864, të cilat përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**1.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)**

Institucioni i Pushtetit Qendror
Bashkia Korçë
Fusha e përdorimit të pronës: zhvillim ekonomik

Nr.	A			B			C			
	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sipërfaqja totale e pronës (m ²)	Nga sipërfaqja totale: sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
861	8564 Ko-M-8	3/511	Ndërtesë + truall	Markata e qytetit Bulevardi Kiço Greco, Korçë	870	870	Tregtim	Bashkia Korçë	Bashkia Korçë	
862	8564 Ko-M-8	3/358	Truall	“Pazari” Tregu i hapur i qytetit “Ish tregu i drithit” Korçë	3515		Tregtim	Bashkia Korçë	Bashkia Korçë	
863	8564 Ko-N-8	2/144	Ndërtesë + truall	“Sheshi i pazarit”	253	253	“Sheshi i pazarit”	Bashkia Korçë	Bashkia Korçë	
864	8564 Ko-M-8		Ndërtesë + truall	Tregu i mishit Bulevardi Kiço Greco, Korçë			Tregtim	Bashkia Korçë	Bashkia Korçë	Ende i përgjigjshëm dhe hedhur në hartë. Në krah të markatës së qytetit
865	8564 Ko-L-7 Ko-L-8		Ndërtesë + truall	“Tregu i ri i shumicës” fruta perime	12000	4790	Tregtim me shumicë	Bashkia Korçë	Bashkia Korçë	

**1.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË VEÇANTA)**

Institucioni i Pushtetit Qendror
Bashkia Korçë
Fusha e përdorimit të pronës: zhvillim ekonomik

Nr.	A			B			C			
	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sipërfaqja totale e pronës (m ²)	Nga sipërfaqja totale: sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
956	8564 Ko-M-8		Ndërtesë + truall	Tregu i peshkut Bulevardi Kiço Greco, Korçë	170	170	Tregtim	Bashkia Korçë	Bashkia Korçë	Mbrapa markatës së qytetit

VENDIM
Nr.310, datë 21.4.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E KOSTOS MESATARE, LEKË PËR METËR KATROR, PËR
OBJEKTET SHTETËRORE TË TRANSFORMUARA NË FOND BANESASH, KALUAR NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE, ME QËLLIM
PRIVATIZIMI, PËR BANORËT POSEDUES, SIPAS VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, TË PERIUdhËS 2009-2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 34/1 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit në zonat urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për të gjitha objektet shtetërore, të transformuara në fond banesash me investimin e qytetarëve gjatë viteve 1991 e në vijim dhe të kaluara në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi, për banorët posedues, me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave të periudhës 2009-2011, kostoja mesatare, lekë për metër katror, të jetë 35 për qind e çmimit njësi për sipërfaqe ndërtimi, të miratuar me vendimin nr.815, datë 9.12.1996 të Këshillit të Ministrave, referuar vitit 1995, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave të kryejë përlllogaritjet sipas pikës 1 të këtij vendimi, për të gjitha kontratat e lidhura gjatë periudhës 2010-2011 dhe të ftojë, brenda 6 (gjashtë) muajsh, lidhjen e kontratave të reja me të gjithë poseduesit, të cilët nuk kanë kryer ende procedurën. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**KOSTOJA MESATARE E NDËRTIMIT PËR VITIN 1995
PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE**

Nr.	Qyteti	Çmimi për njësi (mesatare arith.)	
		Sipërfaqe shfrytëzimi lekë/m ²	Sipërfaqe ndërtimi lekë/m ²
1	Berat	17,053	13,219
2	Dibër	16,353	12,643
3	Durrës	17,483	13,849
4	Elbasan	13,691	10,718
5	Ersekë	16,365	12,652
6	Fier	17,484	13,517
7	Gramsh	13,691	10,718
8	Gjirokastër	19,171	14,861
9	Korçë	16,365	12,652
10	Krujë	15,626	12,081
11	Kavajë	17,916	13,851
12	Kuçovë	16,537	12,785
13	Kukës	19,324	14,910
14	Laç	18,002	13,918
15	Lezhë	16,638	12,863
16	Librazhd	15,637	12,241
17	Lushnjë	16,979	13,127
18	Mat	19,920	14,627
19	Përrenjas	16,114	12,615

20	Peqin	14,010	10,967
21	Përmet	19,265	14,934
22	Pogradec	15,498	11,982
23	Pukë	20,000	15,504
24	Rrëshen	17,095	13,216
25	Skrapar	19,222	14,901
26	Sarandë	16,063	12,452
27	Shkodër	19,172	14,862
28	Tepelenë	19,294	14,957
29	Tropojë	19,530	15,099
30	Tiranë	16,664	12,883
31	Vlorë	17,017	13,175
32	Bulqizë	16,761	12,958
	Kostoja mesatare	16,662	12,899

UDHËZIM
Nr.9, datë 2.5.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.22, DATË 12.10.2010 “PËR PROCEDURAT E SHITJES SË OBJEKTEVE TË MIRATUARA PËR PRIVATIZIM SIPAS VENDIMIT NR.676, DATË 18.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË OBJEKTEVE TË ISH-QYTETIT TË NXËNËSVE, PRANË SHKOLLËS SË MESME TEKNOLOGJIKE, TIRANË”, VENDIMIT NR.678, DATË 18.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KTHIMIN NË FOND BANESASH TË DISA OBJEKTEVE TË ISH-KOMBINATIT TË TEKSTILEVE TË PAMBUKTA, NË TIRANË, TË NDËRMARRJES MEKANIKE-TEKSTILI, TIRANË, DHE TË ISH-SHKOLLËS SË PARTISË, TIRANË”, VENDIMIT NR.708, DATË 23.6.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË OBJEKTEVE TË ISH-KONVIKTIT DHE TË SHKOLLËS KOMUNALE, TIRANË, ME QËLLIM PRIVATIZIMI”, VENDIMIT NR.1285, DATË 23.12.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIMIN E ISH-OBJEKTIT TË KURSIT TË NDËRLIDHJES SË PTT-SË, TIRANË, NGA ISH-MINISTRIA E EKONOMISË DHE PRIVATIZIMIT, SOT MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, PËR QËLLIM PRIVATIZIMI”, VENDIMIT NR.601, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KALIM OBJEKTESH NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, TË OBJEKTIT ISH-KOPSHTI NR.26, NË TIRANË, ME QËLLIM PRIVATIZIMI””

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit 9232 “Për programet sociale të strehimit në zonat urbane”, të ndryshuar, vendimit nr.310, datë 21.4.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koston mesatare, lekë për metër katror, për objektet shtetërore të transformuara në fond banesash, kaluar në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi për banorët posedues, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, të periudhës 2009-2011”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

1. Në udhëzimin nr.22, datë 12.10.2010 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit “Për procedurat e shitjes së objekteve të miratuara për privatizim sipas vendimit nr.676, datë 18.6.2009 i Këshillit të Ministrave “Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, të objekteve të ish-Qytetit të Nxënësve, pranë Shkollës së Mesme Teknologjike, Tiranë”, të vendimit nr.678, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kthimin në fond banesash të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta, në Tiranë, të ndërmarrjes Mekanike-Tekstili, Tiranë, dhe të ish-Shkollës së Partisë, Tiranë”, vendimi nr.708, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për Entin Kombëtar të Banesave, të objekteve të ish-konviktit dhe të Shkollës Komunale, Tiranë, me qëllim privatizimi”, vendimi nr.1285, datë 23.12.2009 i Këshillit të Ministrave “Për kalimin e ish-objektit të Kursit të Ndërlidhjes së PTT-së, Tiranë, nga ish-Ministria e Ekonomisë dhe Privatizimit, sot Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi”, të vendimit nr.601, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kalim objektësh në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për Entin Kombëtar të Banesave, të objektit ish-Kopshti nr.26, në Tiranë, me qëllim privatizimi”, të bëhet një ndryshim si vijon:

Në pikën 4. Vlera totale e privatizimit të banesës, përmbajtja e koeficientit “K”, të ndryshojë në:

“..K- është kostoja lekë/m² për sipërfaqen e ndërtimit të objektit, referuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.310, datë 21.4.2011 “Për përcaktimin e kostos mesatare, lekë për metër katror, për objektet shtetërore të transformuara në fond banesash, kaluar në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi për banorët posedues të Këshillit të Ministrave.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

URDHËR
Nr.3210, datë 25.4.2011

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, Zëvendësministres së Drejtësisë znj.Brikena Kasmi, deri në emërimin e Ministrit të Drejtësisë.
2. Ngarkohet Zëvendësministrja e Drejtësisë për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr.30, datë 23.3.2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE TË BLERJES NGA KESH
SHA, SË ENERGIJISË ELEKTRIKE, NGA TREGTARËT VENDAS DHE TË HUAJ**

Në mbështetje të nenit 3 pika 35/1, nenit 8 pika 2, germa "1", dhe nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, vendimit të Këshillit Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike", të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.3.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e KESH sh.a., për miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes nga KESH sh.a., të energjisë elektrike, nga tregtarët vendas dhe të huaj,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave dhe procedurave të blerjes nga KESH sh.a., të energjisë elektrike, nga tregtarët vendas dhe të huaj (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë KESH sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

RREGULLORE
E PROCEDURAVE TË BLERJES NGA KESH SHA (KESH GEN/ FPSH)
TË ENERGIJISË ELEKTRIKE, NGA TREGTARËT VENDAS DHE TË HUAJ

Neni 1
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të:

- nenit 8 pika 2 germa 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar,
- vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe
- rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin nr.68, datë 23.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

Neni 2
Objekti dhe qëllimi

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave për blerjen nga KESH sh.a. (KESH GEN/ FPSH) të energjisë elektrike nga tregtarët vendas apo të huaj, për të:

i) siguruar diferencat e sasive të energjisë elektrike, të cilat nuk arrijnë të plotësohen nga prodhimi vendas dhe garantuar furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve tariforë, në përputhje me parimet dhe dispozitat e modelit dhe rregullave të tregut të energjisë elektrike;

ii) mundësuar optimizimin e shfrytëzimit të rezervës hidroenergetike apo për përfitim ekonomik.

2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është:

- i) të përcaktojë procedura eficiente dhe praktike për KESH sh.a. (KESH GEN/ FPSH) për blerjen e energjisë elektrike nga tregtarët;
- ii) të sigurojë blerje të energjisë elektrike me kosto sa më të ulët;
- iii) të nxitë pjesëmarrjen e tregtarëve në procesin e blerjes së energjisë elektrike;
- iv) të nxitë konkurrencën në procesin e blerjes së energjisë elektrike;
- v) të sigurojë transparencë, si dhe një trajtim të barabartë për të gjithë tregtarët, pjesëmarrës në procedurat e blerjes së energjisë elektrike.

Neni 3

Parimet

Procedurat e blerjes së energjisë elektrike, sipas kësaj rregulloreje, do të realizohen në përputhje me parimet e barazisë, konkurrencës dhe transparencës.

Neni 4

Përcaktime

Në këtë rregullore termit e përdorur më poshtë do të kenë kuptimin:

1. ERE: do të thotë Enti Rregullator i Energjisë, i cili është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

2. Autoriteti blerës/blerësi: do të thotë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare KESH sh.a. me strukturat e saj KESH Gen dhe Furnizuesi Publik me Shumicë (FPSH), të cilat kryejnë përkatësisht aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike dhe atë të furnizuesit publik me shumicë, sipas licencave të lëshuara nga Enti Rregullator i Energjisë dhe që në bazë të modelit dhe rregullave të tregut të energjisë elektrike kanë përgjegjësi për blerjen e energjisë elektrike nga tregtarët për të siguruar furnizim të mjaftueshëm për OSSH/Furnizuesin Publik me Pakicë (FPP) sipas kërkesës së këtij të fundit, me qëllim furnizimin pa ndërprerje të konsumatorëve/klientëve tariforë.

3. Titullari i autoritetit blerës: do të thotë Drejtori i Përgjithshëm/Administratori i KESH sh.a. ose personi i autorizuar prej tij në mënyrë të dokumentuar.

4. OSSH/FPP: do të thotë operatori i sistemit të shpërndarjes/furnizuesi publik me pakicë, i cili në bazë të modelit dhe rregullave të tregut të energjisë elektrike kryen aktivitetin e shpërndarjes dhe të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët/klientët tariforë.

5. Blerje e energjisë elektrike: do të thotë kalimi në sasi dhe në kohë i energjisë elektrike nga tregtarët e energjisë elektrike tek autoriteti blerës kundrejt pagesës dhe kushteve të tjera të përcaktuara në kontratën përkatëse të shit-blerjes, dhe sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

6. Plani i optimizimit të burimeve hidroenergjetike: është programi i hartuar mbi baza vjetore, mujore, javore dhe ditore, nga KESH sh.a., i cili përcakton sasinë e energjisë elektrike që do të prodhohet në periudhat kohore, dhe nivelin e rezervuarit të çdo centrali, me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe efikasitetin e shfrytëzimit të kaskadës nëpërmjet:

- prodhimit eficient të energjisë elektrike prej centraleve të kaskadës;
- kryerjes së transaksioneve fitimprurëse dhe minimizimin e kostove të prodhimit të energjisë;
- minimizimin e kalimit në situatat që imponojnë shkarkimin urgjent të ujit pa përfitim të energjisë elektrike nga kaskada.

7. Tregtar i energjisë elektrike: do të thotë çdo person fizik apo juridik/shoqëri vendase apo e huaj që ushtron aktivitet të licencuar, për tregtimin e energjisë elektrike me shumicë.

8. Kërkesa/ftesa për ofertë: do të thotë dokumenti zyrtar që autoriteti blerës u drejton tregtarëve të energjisë elektrike për paraqitje të ofertave.

9. Ofertues: do të thotë tregtari i energjisë elektrike që paraqet një ofertë pas dërgimit të kërkesës/ftesës për ofertë nga autoriteti blerës.

10. Ofertë: do të thotë tërësia e dokumenteve dhe korrespondencës të dërguar me postë, faks, e-mail ose dorazi dhe të administruara nga autoriteti blerës sipas rregullave në fuqi, me anë të të cilave një ofertues dërgon në përgjigje të një “Ftesë për ofertë” të shpallur dhe dërguar nga autoriteti blerës.

11. Terma komercialë: është tërësia e elementeve që kanë të bëjnë me kushtet teknike, sasinë, çmimet e shit-blerjes, lëvrimin, kapacitetet e interkonjeksionit, si dhe tarifat apo pagesat e tjera që shoqërojnë transaksionin e blerjes.

12. Kapacitetet e transmetimit/interkonjeksionit: janë kapacitetet e interkonjeksionit, të cilat i alokohen KESH sh.a./FPSH në bazë të rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) apo që sigurohen nga tregtarët, për të mundësuar blerjen nga importi të energjisë elektrike.

Neni 5 **Përgjegjësitë**

Autoritetit blerës është përgjegjës për përcaktimin në sasi dhe në kapacitet, të energjisë elektrike që ai do të blejë sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore, si dhe për përcaktimin e periudhës kohore dhe programit të lëvrimin të saj që duhet të llogaritet duke marrë parasysh planin e optimizimit të burimeve hidro, të kryer në përputhje me përcaktimet e modelit të tregut të energjisë elektrike, rregullave të tregut të energjisë elektrike, dhe kodeve të funksionimit të rrjetit.

Neni 6 **Zbatimi**

Procedurat e blerjes së energjisë elektrike të përcaktuara në këtë rregullore do të zbatohen në rastet:

- i) kur nevojat e OSSH/FPP për plotësimin e kërkesës për energji të konsumatorëve/klientëve tariforë nuk arrijnë të plotësohen nga prodhimi vendas;
- ii) dhe/ose për efekt optimizimi të rezervës energjetike apo portofolit ekonomik të autoritetit blerës.

Neni 7 **Përfshirja e veçantë**

Procedurat e blerjes së energjisë elektrike të përcaktuara në këtë rregullore nuk zbatohen për blerjen e saj nga prodhuesit vendas të licencuar që kanë një marrëveshje shitblerje sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8 **Kontratat për blerjen e energjisë elektrike**

Blerja e energjisë elektrike nga ana e autoritetit blerës prej tregtareve të energjisë elektrike/shoqërive që ofrojnë shitje të energjisë elektrike, në kuptim të nenit 5, të këtyre rregullave kryhet, mbi bazë të kontratave që rrjedhin nga negociatat që autoriteti blerës zhvillon me tregtarët vendas apo të huaj, që ofrojnë të shesin energji elektrike, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 9 **Ftesa për blerje të energjisë elektrike**

1. Për çdo blerje të energjisë elektrike, në përputhje me këtë rregullore, titullari i autoritetit blerës, harton ftesën me termat përkatës për blerjen e energjisë elektrike. Ftesa përmban të paktën:
 - Sasinë e energjisë elektrike në MWh që kërkohet për t'u blerë;

- Grafikon ditor të lëvrimit;
- Kohëzgjatjen e lëvrimit në ditë/muaj/javë;
- Periudhën e plotë kohore të lëvrimit të energjisë elektrike të përcaktuar në marrëdhëniet kontraktuale (shit-blerjes);
- Siguruesin e kapaciteteve të transmetimit;
- Pikën e lëvrimit të energjisë elektrike (linjën përkatëse të interkonjeksionit),
- Kërkesat për kualifikimin në procedurën e blerjes, siç parashikohet në nenin 10 dhe kriterin e vlerësimit të ofertave.

2. Autoriteti blerës do të publikojë në faqen e tij zyrtare të internetit çdo ftesë për blerje të energjisë elektrike në të njëjtën ditë që fton kompanitë e listuara prej tij, për të marrë pjesë në procesin e blerjes së energjisë.

Neni 10

Dokumentacioni ligjor - administrativ

1. Çdo tregtar ofertues që dëshiron të marrë pjesë në procedurën e blerjes së energjisë elektrike duhet të paraqesë pranë autoritetit blerës, dokumentacionin e nevojshëm administrativ që vërteton aftësinë e tij ligjore, si dhe atë të tregtimit të energjisë elektrike, nga institucionet kompetente të shteteve përkatëse ku janë regjistruar dhe ushtron aktivitetin apo ka selinë e tij qendrore, si dhe nga institucionet e shtetit shqiptar si më poshtë vijon:

1.1 Dokumentacionin që vërteton regjistrimin e shoqërisë në regjistrat përkatës tregtar gjyqësor të shtetit në të cilin shoqëria është krijuar apo regjistruar.

1.2 Licencën për tregtimin e energjisë elektrike të lëshuar nga ERE për tregtarët, të cilët janë krijuar apo regjistruar në Republikën e Shqipërisë, apo shtetet përkatëse për ata tregtare të energjisë elektrike, të cilët janë krijuar apo regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë.

1.3 Dokumentacionin e lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës, të cilët vërtetojnë se:

- Tregtari nuk është në proces falimentimi
- Tregtari nuk është i dënuar për shkelje penale
- Nuk është i dënuar me vendim të gjykatës për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike
- Kapitalet/asetet e tij nuk janë objekt i procedurave përmbarimore.

2. Në bazë të këtyre dokumenteve, autoriteti blerës do të hartojë listën e shoqërive të përzgjedhura që do të ftohen prej tij në procedurat e blerjes së energjisë elektrike që do të zhvillohen në vazhdimësi.

3. Ky informacion do të kërkohet çdo vit nga të gjithë tregtarët me të cilët autoriteti blerës bashkëpunon ose ka marrëdhënie kontraktore gjatë viteve të fundit. Ky informacion duhet të paraqitet brenda datës 30 nëntor të çdo viti dhe do të jetë i vlefshëm për vitin pasardhës.

4. Tregtarët që shprehin për herë të parë interesin e tyre për të marrë pjesë në procedurat e blerjes së energjisë elektrike, të zhvilluar nga autoriteti blerës, të cilët nuk kanë depozituar dokumentacionin ligjor të kërkuar më parë do të paraqesin dokumentacionin e mësipërm pranë këtij të fundit së bashku me shprehjen e interesit.

5. Pas përfshirjes në listën e shoqërive që autoriteti blerës i dërgon ftesë për pjesëmarrje në procedurat e blerjes, tregtarët/shoqëritë pjesëmarrëse paraqesin në procedurën e blerjes vetëm formularin e ofertës me të dhënat e kërkuara.

Neni 11

Kriteret e vlerësimit të ofertave

Në ftesën për blerje që autoriteti blerës i drejton tregtarëve, kandidatë, përcakton kriterin kryesor të vlerësimit të ofertave të kualifikuara sipas kriterëve të kualifikimit të përcaktuara në këtë rregullorë, i cili në këtë rast do të jetë çmimi/njësi dhe/ose çmimet/njësi më të ulëta, të cilat rezultojnë të tilla në përfundim të procedurës së negocimit. Në rastet e aplikimit të procedurave të

blerjes së energjisë elektrike sipas kësaj rregulloreje, autoriteti blerës nuk përllongarit çmim/njësi maksimal të blerjes së energjisë elektrike.

Neni 12

Komunikimi i autoritetit blerës me shoqëritë pjesëmarrëse në procedurat e blerjes së energjisë elektrike

I gjithë komunikimi i autoritetit blerës me shoqëritë pjesëmarrëse në procedurat e blerjes së energjisë do të kryhet njëherazi nëpërmjet faksit dhe e-mailit. Mënyra e komunikimit do të jetë e njëjtë për të gjithë.

Neni 13

Procedura e vlerësimit dhe negocimit të ofertave

1. Në bazë të nevojës për blerje të energjisë elektrike të përcaktuar nga KESH sh.a./FPSH, titullari i autoritetit blerës nxjerr urdhrin për zhvillimin e procedurës së blerjes së energjisë elektrike Ky urdhër përbën një akt ekzekutiv të titullarit të autoritetit blerës, që përcakton të dhëna të karakterit tekniko-ekonomik të blerjes së energjisë elektrike, si dhe përcakton anëtarët e komisioneve që do të kryejnë zhvillimin e procedurës së Blerjes.

Ky urdhër duhet të përmbajë:

- sasinë e energjisë elektrike në MWh që do të blihet;
- grafikun ditor të lëvrimin të energjisë elektrike;
- siguruesin e kapaciteteve të transmetimit;
- kohëzgjatjen e periudhës së lëvrimin të energjisë elektrike;
- datën/orën e paraqitjes së ofertave;
- kriterin e vlerësimit të ofertave;
- pikën e lëvrimin të energjisë elektrike (linjën përkatëse të interkonjeksionit).

Në çdo rast, titullari i autoritetit blerës mund të përcaktojë në këtë urdhër edhe kërkesa dhe kushte të tjera.

2. Komisioni i blerjes së energjisë elektrike nis ftesën për ofertë, që i drejtohet në mënyrë të njëkohshme e të dokumentuar me faks ose e-mail të gjitha tregtarëve të energjisë elektrike të përcaktuar si më lart në këtë rregullore. Ftesa përmban të paktën kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, si dhe në nenin 9. Kjo ftesë për ofertë publikohet në faqen zyrtare të internetit, faqen elektronike të autoritetit blerës në po të njëjtën ditë që iu drejtohet tregtarëve/shoqërive të ndryshme nga autoriteti blerës.

3. Brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i shkurtër se 24 orë, komisioni i blerjes së energjisë elektrike do të pranojë ofertat e tregtarëve kandidatë që kanë paraqitur ofertë. Komisioni do të bëjë hapjen dhe leximin e ofertave në prani të palëve në orën dhe në datën e përcaktuar në ftesën për ofertë. Komisioni do të vlerësojë jo më vonë se 48 orë nga pranimi i tyre, ofertat e paraqitura, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ftesën që i është drejtuar të gjitha shoqërive dhe atyre shoqërive që kanë shfaqur interes, si dhe do të klasifikojë paraprakisht ofertat që rezultojnë të vlefshme. Komisioni do të zbatojë të njëjtën procedurë edhe në kushtet e paraqitjes së vetëm një ofertë. Komisioni do të bëjë njoftimin për skualifikim të ofertuesve sipas nenit 17 të kësaj rregullore.

4. Komisioni i blerjes negocion me shoqërinë apo shoqëritë e përzgjedhura nga ky komision pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave. Komisioni i blerjes në procesin me negocim do të komunikojë me e-mail dhe faks dhe njëherazi brenda 24 orësh, me 5 shoqëritë që kanë paraqitur ofertat me çmimet/njësi më të ulëta apo me më shumë shoqëri deri në plotësimin e gjithë sasisë së kërkuar për prokurim, duke pasur si kusht uljen e çmimit/njësi të paraqitur nga shoqëritë. Komisioni në ftesën për negocim do të përcaktojë afatin e pranimit të ofertave të negociuara, i cili në çdo rast nuk do të jetë më pak se 4 orë pune nga marrja e ftesës për negocim.

5. Në përfundim të procedurës së negociimit, komisioni i blerjes do t'i paraqesë brenda 24 orëve për miratim titullarit të autoritetit blerës një raport përmbledhës të procedurave të kryera dhe propozimin për shpalljen fituese të tregtarit(ëve)/shoqërisë(ve) që kanë paraqitur çmimet/njësi më të ulëta, deri në plotësimin e sasisë së kërkuar nga KESH sh.a. për blerje të energjisë elektrike.

6. Titullari i autoritetit blerës jo më vonë se 24 orë nga marrja e raportit përmbledhës, në rast të miratimit prej tij, shpall ofertën/ofertat fituese.

7. Komisioni i blerjes ka përgjegjësinë për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjitha ofertave të marra nga tregtarët pjesëmarrës në procedurë.

8. Brenda një afati jo më shumë se 24 orë, nga marrja e vendimit për shpalljen e ofertës/ofertave fituese, autoriteti blerës, do të negociojë për lidhjen e kontratës. Nëse ofertuesi fitues refuzon të lidhë kontratën për blerjen e energjisë elektrike, atëherë autoriteti blerës do të procedojë me negociimin për lidhjen e një kontrate me ofertuesin e radhës, të kualifikuar.

9. I gjithë dokumentacioni shoqëruar i të gjithë procedurës së blerjes së energjisë, së bashku me kontratën e lidhur midis autoritetit blerës dhe ofertuesit(ve) fitues, do të dokumentohet dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 14

Sqarimi dhe korrigjimi i ofertave

1. Për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të ofertave të paraqitura nga ofertuesit, autoriteti blerës, kur e gjykon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime ose informacion lidhur me to.

2. Autoriteti blerës korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi nuk ndikon drejtpërsëdrejti në kushtet dhe kriteret thelbësore të ofertës.

Neni 15

Deklarata e konfliktit të interesave

Pas pranimit të ofertave, çdo anëtar i komisionit do të nënshkruajë deklaratën, me anë të së cilës shpreh mungesën e konfliktit të interesave të tij me ofertuesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëse një nga anëtarët e Komisionit është në kushtet e konfliktit të interesave me një nga ofertuesit, atëherë Kryetari i Komisionit do t'i kërkojë titullarit të autoritetit blerës zëvendësimin e tij. Deri në emërimin e anëtarit tjetër, Komisioni nuk do të procedojë me vlerësimin e ofertave.

Neni 16

Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës

Njoftimi i fituesit i jepet menjëherë ofertuesit/ve, që ka paraqitur ofertën më të mirë në procesin e negociimit. Njoftimi i fituesit përmban të paktën:

- emrin, adresën e ofertuesit;
- periudhën e furnizimit me energji elektrike;
- profilin e furnizimit me energji elektrike;
- sasinë, çmimin/njësi dhe vlerën e kontratës;
- pikën e lëvrimin të energjisë elektrike (linjën përkatëse të interkonjeksionit);
- mënyrën e sigurimit të kapaciteteve të transmetimit/interkonjeksionit.

Pas shpalljes së njoftimit të fituesit, autoriteti blerës dhe ofertuesi i shpallur fitues nënshkruajnë kontratën.

Neni 17

Njoftimi i skualifikimit të ofertuesve

Njoftimi i skualifikimit të ofertave u jepet ofertuesit/ve, menjëherë pas vlerësimit përfundimtar të ofertave. Ky njoftim përmban të paktën:

- emrin, adresën e ofertuesit;
- referencën e procedurës së blerjes;
- objektin e procedurës së blerjes;
- periudhën e furnizimit të energjisë elektrike;
- datën e paraqitjes së ofertës;
- shkakun/shkaqet e skualifikimit.

Neni 18

Anulimi i procedurës së blerjes së energjisë elektrike

Autoriteti blerës mund të anulojë procedurën e blerjes së energjisë elektrike për një nga arsyet e mëposhtme:

- nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore të paraqitjes së tyre;
- asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret dhe/ose kushtet tekniko-ekonomike, të përcaktuara në “Ftesën për ofertë”;
- për arsye të tjera të vërtetueshme e të dokumentueshme, jashtë kontrollit të autoritetit blerës dhe të paparashikueshme prej tij në kohën e njoftimit apo zhvillimit të procedurës së blerjes së energjisë elektrike, në interes të korporatës apo konsumatorëve tariforë.

Neni 19

Publikimi në faqen zyrtare të internetit (*web-site*) i procedurës së blerjes

Në faqen zyrtare të internetit (*web-site*) të autoritetit blerës publikohet “Ftesa/kërkesa për ofertë”, raporti përmbledhës ose njoftimeve të tjera me anë të të cilëve autoriteti blerës njofton tregtarët e interesuar për pjesëmarrje në procedurën e blerjes së energjisë elektrike, si dhe shpallja e ofertave fituese/jofituese etj.

Neni 20

Procedura e ankimit administrativ

1. Çdo tregtar ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procedurës së ndjekur për një blerje, kur gjykon se një vendim i autoritetit blerës është marrë në kundërshtim me këtë rregullore, duke ndjekur hapat e mëposhtëm.

2. Ofertuesi i paraqet me shkrim (me postë, fax, e-mail ose dorazi/me protokoll), titullarit të autoritetit blerës, brenda 24 orësh nga momenti i njoftimit të skualifikimit ose shkeljes së pretenduar, ankesën përkatëse. Në këtë ankesë, ankimuesi duhet të referojë emrin dhe adresën, referimin për procedurën konkrete ku ka marrë pjesë, bazën ligjore dhe përshtetshmërinë e shkeljes së pretenduar. Me marrjen e ankesës si më sipër, titullari i autoritetit blerës pezullon vazhdimin e procedurës së blerjes në fjalë, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht dhe ky shqyrtim të jetë shprehur në formën e një vendimi të shkruar nga titullari i autoritetit blerës, i cili i dërgohet ankimuesit (me postë, fax, e-mail ose dorazi/me protokoll), brenda 24 orësh nga marrja e ankesës.

3. Në çdo rast të paraqitjes së një ankesë, titullari i autoritetit blerës është i detyruar të shprehet me vendim për pranimin, apo refuzimin e ankesës.

4. Kur subjekti nuk është dakord me trajtimin e ankesës nga titullari i autoritetit blerës atëherë i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas Kodit të Procedurës Civile apo Gjykatës së Arbitrazhit, të përcaktuar nga palët.

Neni 21

Monitorimi i shitjes së energjisë elektrike

1. Të gjitha operacionet e blerjes së energjisë elektrike do të dokumentohen me saktësi. Asnjë blerje nuk do të kryhet pa dokumentacionin shoqërues të kërkuar, i cili në çdo rast do të mbahet edhe në gjuhën shqipe.

2. Deri më datë 15 të çdo muaji, titullari i autoritetit blerës paraqet në ERE një raport përmbledhës të zhvillimit të procedurës/ave të blerjes së energjisë elektrike gjatë muajit paraardhës.

3. Autoriteti blerës ka detyrimin që t'i japë në mënyrë transparente ERE-s të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej saj, për blerjet e energjisë elektrike në kuadër të autoritetit të ERE-s për të monitoruar autoritetin blerës.

Neni 22 **Rishikimi**

Këto rregulla janë objekt rishikimi me vendim të Bordit të Komisionerëve, sipas procedurave të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s.

Neni 23 **Sanksione**

Për shkeljen e këtyre rregullave, kur nuk përben vepër penale, ERE vepron në përputhje me nenin 64, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 24 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM **Nr.32, datë 31.3.2011**

PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GSA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGIJËSË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pikat 1 dhe 3, neni 16 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “GSA” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi rinovimin e licencës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

- Bazuar në vendimin nr.79, datë 21.12.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. “Për rinovimin e licencës në aktivitetin e importit të energjisë elektrike”, licenca e subjektit “GSA” sh.p.k., për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike ka përfunduar që në datën 26.1.2011 dhe aktualisht subjekti nuk ka licencë.

- Kërkesa për rinovimin e licencës së këtij subjekti është paraqitur në ERE, në datën 17.3.2011, pra në mosrespektim të afatit të paraqitjes së kërkesës për rinovim të licencës sipas nenit 16 pika 1, në të cilin përcaktohet se: “Jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës.”

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurat e shqyrtimit të aplikimit për rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.33, datë 6.4.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDRO ENERGJIA PULITA” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.4.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Idro Energjia Pulita” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Idro Energjia Pulita” sh.p.k., plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me miratimin e pikës së lidhjes në rrjetin e shpërndarjes është në proces përfundimi (neni 9 pika 4.1.5).

Për gjithë sa më sipërcituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Idro Energjia Pulita” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Gostivisht”, “Langarica 3” dhe “Ura e Dashit”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.34, datë 6.4.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BEKIM ENERGETIK” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.4.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Bekim Energjetik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Bekim Energjetik” sh.p.k., plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikua nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me paraqitjen e pikës së lidhjes, me OST sh.a., është në proces përfundimi (neni 9 pika 4.1.5).

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Bekim Energjetik” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Kryezi 1” dhe “Kryezi i Epërm”.

2. Drejtorja e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
NË DETYRË
Entela Shehaj

VENDIM
Nr.35, datë 6.4.2011

PËR MOSFILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERALD ENERGETIK” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 pikat 1 dhe 3, neni 16 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.4.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Erald Energjetik” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

- Ndryshe nga përcaktimet e kontratës koncesionare të datës 16.6.2009 (nenet 2 dhe 3 në të cilat përcaktohet ndërtimi dhe vënia në punë e dy heceve: hec “Shemri” me fuqi 800 kW dhe hec “Mgulle” me fuqi 280 kW), shoqëria “Erald Energjetik” sh.p.k. ka paraqitur në ERE aplikimin për licencim vetëm për hec “Shemri”, ndërsa për hec “Mgulle” nuk është paraqitur asnjë dokumentacion.

- Dokumentacioni i përgjithshëm për hec “Mgulle”, neni 9 pikat 1,2,3 dhe 4 nuk është plotësuar.

- Dokumentacioni i përgjithshëm për hec “Shemri”, neni 9 pikat 1,2,3 dhe 4 është plotësuar pjesërisht.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurat e shqyrtimit të aplikimit për licencimin e shoqërisë “Erald Energjetik” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
NË DETYRË
Entela Shehaj

KËRKESË
Nr.1570/3, datë 30.3.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Në mbështetje të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan (loti I).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar (sipërfaqet m²), si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 (objektet), për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Lidhur me listën ku janë pasqyruar pronarët dhe sipërfaqet (tokë), të cilat preken nga ndërtimi i këtij segmenti rrugor, është bërë shënimi “Rikonfirmim pranë ZVRPP-së”, për arsye se nga ZVRPP-ja Tiranë për një pjesë të konsiderueshme të pasurive ka të dhëna, të paqarta dhe jo të plota. Për sa u përket pasurive me pronar të paidentifikuar sqarojmë se nuk ka asnjë lloj informacioni nga ZVRPP-ja. Për të gjitha këto pasuri do të rikërkohet konfirmim pranë ZVRPP-së Tiranë dhe në bazë të konfirmimit përfundimtar që do të jepet nga kjo zyrë, do të hartohen dhe listat që do të shoqërojnë projektvendimin që do të propozohet për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Lidhur me objektet për të cilat është bërë shënimi “Konfirmim nga ALUIZNI”, pronarët përkatës do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit dhe ai i regjistrimit pranë ZVRPP-së, në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Për objektet për të cilat është bërë shënimi “I pakonfirmuar”, sqarojmë se nuk janë konfirmuar nga ALUIZNI dhe nuk disponojmë të dhëna as nga ZVRPP-ja Tiranë. Qytetarët, të cilët pretendojnë pronësinë duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre pranë ZVRPP-së Tiranë, si dhe të paraqesin pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dokumentacionin tekniko-ligjor (nëse disponojnë të tillë), nëpërmjet të cilit vërtetojnë titullin e pronësisë mbi këto objekte.

Për objektin për të cilin është bërë shënimi “Rikonfirmim pranë ALUIZNI”, do të rikërkohet konfirmim, pasi nuk është konfirmuar paraprakisht nga kjo Agjenci.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 508 025 259.4 (pesëqind e tetë milionë e njëzet e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë pikë katër) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

OBJEKTET QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË AKSIT
“TIRANË - ELBASAN (UNAZA E RE E TIRANËS – MULLET, LOTI I)”
LLOJI I PASURISË SË PALUAJTSHME: OBJEKTE

Nr.	Pronari			Nr. Pas.	Z.K.	OBJEKTE		Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Vlera në lekë sipas preventivit	LLOJI I OBJEKTIT	
1	HAMEZ	ISMEN	MATRANXHI 1	516/20	3266	3,879,244	BANESE 2KT	Komfirm. nga ALUIZNI
2	SOKOL	HAMEZ	MATRANXHI	516/21	3266	4,181,248	BANESE 1KT	Komfirm. nga ALUIZNI
3	BEKTASH	NOVRUS	BEQARAJ	162/14	3266	4,224,778	BANESE 3KT	Komfirm. nga ALUIZNI
4	HAMEZ	ISMEN	MATRANXHI 2	516/20	3266	4,205,470	BANESE 2KT	Komfirm. nga ALUIZNI
5	IRFAN	ETEM	AJAZI	162/23	3266	2,218,943	BANESE 1KT	I pakonfirmuar
6	HAJDAR	BAJRAM	SHESHI	153/14	3266	1,860,289	BANESE 1KT	Komfirm. nga ALUIZNI
7	ALBERT	PETRIT	SALIU	188/44	3266	3,033,479	BANESE 1KT	I pakonfirmuar
8	DYLBIN	RAMIZ	BALLIU	162/18	3266	2,824,507	BANESE 2KT	I pakonfirmuar
9	VIKTOR	GJET	FRROKU	537//13	2704	6,614,121	LOKAL 2KT	Rikonfirmim prane ALUIZNI
10	KUJTIM	JONUZ	BALLA	537/12	2704	3,344,628	SERVIS MAKINASH 1KT	Komfirm. nga ALUIZNI
11	KADRI	SEFER	HUSHA	533/2	2704	12,399,915	LOKAL 3KT	Komfirm. nga ALUIZNI
12	KADRI	SEFER	HUSHA	533/2	2704	3,807,764	SISTEMIME	Komfirm. nga ALUIZNI
13	NURIE	SEFER	HUSHA	538/4	2704	4,730,925	LAVAZH+SERVIS 1KT	Komfirm. nga ALUIZNI
14	SHKELQIM		DAUTI	479/2	3266	401,991	SHESH	I pakonfirmuar
15	SAMI	NJAZI	IBRAHIMI	-	3266	4,984,236	BANESE 2KT	Komfirm. nga ALUIZNI
16	RODOLF		BRAHO	168/36	3266	5,472,607	BANESE 3KT	I pakonfirmuar
17	LEONARD	KAMAN	LILLO	168/36	3266	5,938,361	BANESE 2KT	Komfirm. nga ALUIZNI
	TOTALI					74,122,506		

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "TIRANË- ELBASAN"
(UNAZA E MADHE E TIRANËS, MULLET, LOTI I)

Nr.	Pronari			Zona kad.	Nr.pas.	Sip. m ²	Çmimi	Vlera	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri						
1	Ismet Alla, Zyber Alimeta			3266	162/20	40	2622.165	104886.6	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
2	Arta + Caje		Brahja	3266	162/18	66	2622.165	173062.89	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
3	Ali	Gani	Haluli	3266	162/14	191	2622.165	500833.515	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
4	Rushan Sherbet	Ramiz	Harizi	3266	69/64	233	2622.165	610964.445	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
5	Selami	Shefki	Harizi	3266	69/62	300	2622.165	786649.5	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
6	Halil	Haki	Brahja	3266	69/66	430	2622.165	1127530.95	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
7	Shkelqim	Hekuran	Boci	3266	69/59	75	2622.165	196662.375	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
8	I paidentifikuar			3266	69/65	460	2622.165	1206195.9	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
9	I paidentifikuar			3266	174	897	2622.165	2352082.005	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
10	Muharrem		Sina	3266	162/15	188	2622.165	492967.02	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
11	Dylbin	Ramiz	Balliu	3266	162/19	55	2622.165	144219.075	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
12	Kadri	Ymer	Buci	3266	162/26	255	2622.165	668652.075	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
13	Ismete	Murat	Xhabrahimi	3266	162/27	3222	2622.165	8448615.63	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
14	I paidentifikuar			3266	162/	2925	2622.165	7669832.625	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
15	Haki	Mahmut	Kosta	3266	162/30	256	2622.165	671274.24	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
16	Sefer + Lulzim	Asllan	Xhabrahimi	3266	162/32	619	2622.165	1623120.135	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
17	Sherbet	Pullumb	Kosta	3266	162/31	235	2622.165	616208.775	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
18	Metije	Ismail	Lika	3266	174/8	1531	2622.165	4014534.615	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
19	Rustem	Selman	Xhabrahimi	3266	164/1	870	2622.165	2281283.55	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
20	Jolldes	Ismail	Aliko	3266	174/10	800	2622.165	2097732	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
21	Ikbale	Ismail	Haxhimali	3266	174/9	1531	2622.165	4014534.615	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
22	Ismete	Murat	Xhabrahimi	3266	174/116	1120	2622.165	2936824.8	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
23	I paidentifikuar			3266	164/	1174	2622.165	3078421.71	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
24	Ramiz		Brahja	3266	153/13	609	2622.165	1596898.485	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
25	Halil		Brahja	3266	153/14	613	2622.165	1607387.145	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
26	Vath	Sali	Brahja	3266	162/21	800	2622.165	2097732	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
27	Mine	Osman	Brahja	3266	153/15	883	2622.165	2315371.695	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
28	I paidentifikuar			3266	153/14	613	2622.165	1607387.145	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
29	Rustem	Musa	Brahja	3266	163/3	500	2622.165	1311082.5	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
30	Bashkim	Bajram	Brahja	3266	163/4	530	2622.165	1389747.45	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
31	I paidentifikuar			3266	163/	656	2622.165	1720140.24	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së

32	Ilmi		Xhabrahimi	3266	162/22	831	2622.165	2179019.115	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
33	Qerim		Brahja	3266	153/22	755	2622.165	1979734.575	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
34	Arben	Derhem	Brahja	3266	153/44	542	2622.165	1421213.43	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
35	Selim	Enver	Zenelaj	3266	168/40	333.3	2622.165	873967.5945	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
36	Ilmi		Xhabrahimi	3266	162/23	374	2622.165	980689.71	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
37	Blerim	Idajet	Saliaj	3266	168/41	333.3	2622.165	873967.5945	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
38	Qerim		Saliaj	3266	168/42	333.4	2622.165	874229.811	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
39	Rodolf	Shene	Braho	3266	168/36	600	2622.165	1573299	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
40	Jovan + Bukuroshe		Çela	3266	168/43	500	2622.165	1311082.5	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
41	Muharem	Myrteza	Brahja	3266	168/44	1650	2622.165	4326572.25	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
42	Leonard	Kaman	Lilo	3266	168/39	468	2622.165	1227173.22	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
43	Blerim	Idajet	Saliaj	3266	168/26	61	2622.165	159952.065	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
44	Shefqet	Rrahman	Brahja	3266	168/6	330	2622.165	865314.45	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
45	Bedri	Sali	Brahja	3266	168/7	255	2622.165	668652.075	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
46	I paidentifikuar			3266	168	5450	2622.165	14290799.25	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
47	Artor	Ismet	Leshja	3266	168/4	6500	2622.165	17044072.5	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
48	Ilijana + Mirjeta		Gjuzi	2704	240/87	355	2622.165	930868.575	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
49	Lume		Gjuzi	2704	240/5	2457	2622.165	6442659.405	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
50	I paidentifikuar			2704	240/13	192	2622.165	503455.68	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
51	Pellumb + Fatmir	Xhipe	Rrapaj	2704	181/20	160	2622.165	419546.4	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
52	Pellumb	Ibrahim	Brusha	2704	181/4	1600	2622.165	4195464	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
53	Haxhi	Sadik	Begu	2704	242/15	1400	2622.165	3671031	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
54	Sadik	Haxhi	Begu	2704	242/14	1000	2622.165	2622165	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
55	Latif		Begu	2704	242/19	774	2622.165	2029555.71	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
56	Hamit	Sulejman	Begu	2704	242/20	440	2622.165	1153752.6	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
57	Ramazan	Sadik	Begu	2704	242/13	1500	2622.165	3933247.5	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
58	I paidentifikuar			2704	242/16	1904	2622.165	4992602.16	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
59	Xhemal	Dalip	Begu	2704	242/9	53	2622.165	138974.745	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
60	Hamit	Sulejman	Begu	2704	242/17	1800	2622.165	4719897	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
61	Sulejman		Begu	2704	250/18	53	2622.165	138974.745	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
62	Genti		Janku	2704	250/6	420	2622.165	1101309.3	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
63	Bilal		Begu	2704	255/15	791	2622.165	2074132.515	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
64	Halit		Begu	2704	255/2	401	2622.165	1051488.165	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
65	Sulejman		Begu	2704	255/11	1900	2622.165	4982113.5	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
66	I paidentifikuar			2704	251/21	695	2622.165	1822404.675	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
67	Enver		Begu	2704	255/3	2555	2622.165	6699631.575	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
68	Zenel		Begu	2704	258/3	5222	2622.165	13692945.63	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
69	Xhemal		Sina	2704	260/7	290	2622.165	760427.85	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
70	Musa		Begu	2704	261/3	190	2622.165	498211.35	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
71	Hamdi		Tujani	2704	258/9	1160	2622.165	3041711.4	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së

72	I paidentifikuar			2704	268/1	3792	2622.165	9943249.68	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
73	Hamit	Beqir	Tujani	2704	270/4	1154	2622.165	3025978.41	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
74	Masar		Dushku	2704	269/2	1850	2622.165	4851005.25	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
75	Vjollca		Dushku	2704	307/24	550	2622.165	1442190.75	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
76	Zyber		Dushku	2704	279/5	1070	2622.165	2805716.55	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
77	Zija		Dushku	2704	307/21	6820	2622.165	17883165.3	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
78	Bekim Murati, Arben Manja			2704	307/8	1104	2622.165	2894870.16	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
79	Sokol Rrapaj, Lorenc Tanku			2704	307/15	177	2622.165	464123.205	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
80	Angejele		Zoto	2704	307/16	616	2622.165	1615253.64	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
81	Haxhi		Dushku	2704	307/23	1300	2622.165	3408814.5	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
82	I paidentifikuar			2704	307/5	5672	2622.165	14872919.88	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
83	Ramiz		Tujani	2704	304/2	562	2622.165	1473656.73	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
84	Bashkim	Ramiz	Tujani	2704	303/6	632	2622.165	1657208.28	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
85	I paidentifikuar			2704	304/1	1227	2622.165	3217396.455	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
86	I paidentifikuar			2704	302	5235	2622.165	13727033.78	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
87	B/pr Bamllari+ Gjocaj			2704	454/9	1259	2622.165	3301305.735	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
88	I paidentifikuar			2704	300/6	581	2622.165	1523477.865	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
89	I paidentifikuar			2704	300/6/2	1042	2622.165	2732295.93	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
90	Haxhi	Sefer	Gjuzi	2704	300/4	690	2622.165	1809293.85	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
91	Haxhi	Sefer	Gjuzi	2704	300/5	900	2622.165	2359948.5	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
92	"Vista Group" Shpk			2704	439/5	700	2622.165	1835515.5	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
93	"Vista Group" Shpk			2704	439/4	1600	2622.165	4195464	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
94	I paidentifikuar			2704	447/1	2719	2622.165	7129666.635	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
95	Adnan		Qejvani	2704	479/2	1889	2622.165	4953269.685	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
96	Shkelqim		Dauti	2704	479/15	1000	2622.165	2622165	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
97	Zyra		Bulku	2704	479/16	7500	2622.165	19666237.5	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
98	"Vista Group" Shpk			2704	476/2	187	2622.165	490344.855	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
99	Iilir		Mitrushi	2704	515/13	1028	2622.165	2695585.62	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
100	Sheje	Ali	Husha	2704	515/9	740	2622.165	1940402.1	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
101	Besim	Imer	Bulku	2704	479/9	2100	2622.165	5506546.5	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
102	Flamur	Sefer	Husha	2704	516/23	2930	2622.165	7682943.45	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
103	Mustafa	Ibrahim	Ruka	2704	479/10	300	2622.165	786649.5	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
104	Ismail	Selim	Disha	2704	479/11	330	2622.165	865314.45	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
105	Haxhi	Ali	Isufi	2704	479/12	270	2622.165	707984.55	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
106	Sheje	Ali	Husha	2704	516/20	1867	2622.165	4895582.055	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
107	Fatos	Abdurrahman	Nurja	2704	519/5	983	2622.165	2577588.195	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
108	Fatos	Abdurrahman	Nurja	2704	528/3	951	2622.165	2493678.915	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
109	Fatmir	Hasan	Husha	2704	528/2	522	2622.165	1368770.13	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
110	Fatos	Abdurrahman	Nurja	2704	529	3200	2622.165	8390928	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
111	Beqir	Kadri	Musha	2704	532/19	5446	2622.165	14280310.59	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së

112	Fatmir	Hasan	Husha	2704	531/1	2042	2622.165	5354460.93	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
113	Pasha	Kadri	Husha	2704	531/2	3406	2622.165	8931093.99	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
114	Arben	Hysen	Caca	2704	484/6/1	387	2622.165	1014777.855	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
115	B/pr Husha			2704	533/2	5609	2622.165	14707723.49	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
116	Bashkepronesi			2704	538/4	4588	2622.165	12030493.02	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
117	Kujtim	Jonuz	Balla	2704	537/12	356	2622.165	933490.74	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
118	Viktor	Gjet	Frroku	2704	537/8	477	2622.165	1250772.705	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
119	I paidentifikuar			2704	537/13	1513	2622.165	3967335.645	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
120	Artur	Staver	Selenica	2704	538/3	2158	2622.165	5658632.07	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
121	Artur	Staver	Selenica	2704	539/2	1921	2622.165	5037178.965	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
122	Petrit		Caushi	2529	483/3	142	2622.165	372347.43	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
123	Shpresa		Shkalla	2529	483/2	130	2622.165	340881.45	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
124	Shpresa		Shkalla	2529	483/2/1	208	2622.165	545410.32	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
125	Dalip		Shaba	2529	483/3/1	738	2622.165	1935157.77	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
		TOTALI				165475		433902753.4	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 2.5.2011

Doli nga shtypi më 3.5.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 44 lekë